



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, dhe neneve 14, 15 parag 2.1 dhe 19 parag. 1.12, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, miratoi,

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH.A. PODUJEVË

Neni 1

1. Ngritet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh. a. – Podujevë, në përbërje si vijon:

z.Adnan Zymeri, anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës
znj.Lirika Maliqi, anëtare e emëruar nga Kuvendi i Komunës

2. Anëtari i emëruar nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.prot.02-020/05-0053551/19 të datës 03 korrik 2019, është pjesë përbërëse e këtij vendimi, respektivisht këtij komisioni.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e anëtarëve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/04-0037944/19 i datës 08 maj 2019.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-104/02-0065942/20
Podujevë,
30 tetor 2020

